



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr 01-112/01-21880
Datë 08.05.2026

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 pikën b të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 85 paragrafi 2 ndërlidhur me nenin 60 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin numër 08/L-294, nenin 53 të Ligjit numër 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pas njoftimit nga nëpunësi Musë Gjergjaj për tërheqje nga vendimmarrja në procedurën disiplinore me numër 01-116/02-19725 dhe me qëllim të mbarëvajtjes së punëve të Komisionit Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Publik në Komunën e Gjakovës, me datë 08.05.2026 merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet pika 2 e vendimit numër 01-112/01-51456 të datës 26.09.2025 për formimin e Komisionit Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Publik në Komunën e Gjakovës, si pasojë e kërkesës së paraqitur nga nëpunësi Musë Gjergjaj për lirim nga përgjegjësitë si anëtar dhe si kryesues i këtij komisioni në raport me procedurën disiplinore me numër 01-116/02-19725 për shkak të shmangies së mundshme të konfliktit të interesit, kështu që i njëjti zëvendësohet me nëpunësin Artan Hoxha.
2. Komisionin Disiplinor në procedurën me numër 01-116/02-19725 sipas pikës 1 të këtij vendimi e përbëjnë:
 - 2.1. Artan Hoxha - Kryesues (Udhëheqës i Sektorit të Inspektoratit të Tregut)
 - 2.2. Liridona Lluka - Anëtare (Zyrtar i Lartë për Burime Njerëzore)
 - 2.3. Besarta Saraqini - Anëtare (Zyrtar i Lartë për Arsimin Parashkollor dhe Fillor)
3. Pjesa tjetër e vendimit numër 01-112/01-51456 të datës 26.09.2025 mbetet e pa ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi iu dërgohet:

- Komisioni Disiplinor
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

